

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**AKT PËRCJELLËS**

Për:	Menaxherin e prokurimit: “Komuna Gjakovë”.	Kopje:	Paneli Shqyrtues – OSHP Nr. 103/17.
Nga:	Visar Bibaj - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën “Furnizim, me produkte ushqimore, higjenike dhe mish për nevojat e Komunës së Gjakovës Lot 1”, me nr. të Prokurimit: 623/17/335/121.		
Përgjigjeje në ankesë:	N.T.P “Dujaku Lux”-Gjakovë		
Datë	24.04.2017		


Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesën e parashtruar nga OE N.T.P “ Dujaku Lux”– Gjakovë, kundër AK – Komuna Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me produkte ushqimore, higjenike dhe mish për nevojat e Komunës së Gjakovës Lot 1”** me nr. të Prokurimit: **623/17/335/121**.

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

- 1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
- 1x1 Autoriteti Kontraktues.
- 1x1 Operatorit ekonomik ankes.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: “Furnizim me produkte ushqimore, higjenike dhe mish për nevojat e Komunës së Gjakovës Lot 1”, me nr. të Prokurimit: **623/17/335/121**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë.

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	18.04.2017	20.04.2017	24.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit	Data e autorizimit të eksp.	Data e fillimit të ekspertizës	Data e dorëzimit të raportit

### N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 07.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 103/17, e parashtruar nga OE N.T.P "Dujaku Lux" me seli në Gjakovë, lidhur me aktivitetin të prokurimit "Furnizim, me produkte ushqimore, higjenike dhe mish per nevojat e Komunës së Gjakovës" Lot - 1, me nr. të Prokurimit: 623/17/335/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Gjakovë.

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) - Komuna Gjakovë.

### N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues N.T.P "Dujaku Lux" me seli në Gjakovë.

*Pikat e Ankesës nga OE N.T.P "Dujaku Lux" nga Gjakova, dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

**Supozojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur:**

- a. Ka pas konfuzitet prej informatave te eprokurimit dhe zyres se prokurimit Gjakove.
- b. Nuk e kemi akoma te kjart si eshte e mundur se njekohsisht te konkurohet edhe ne menyre elektronike edhe fizike per te njejtin tender.
- c. Nuk ka pasur sqarime shites per operatoret elektronik dhe fizik veq e veq, pasi qe jam regulla tjera ne ato elektrtonike dhe ato fizike. Psh ne zyren e prokurimit ne Gjakove ka shkruar afati i sigurimit per 90 dit apo tre muaj ndersa ne eprokurim per te njejtin tender dhe me te njejtin nr te prokurimit eshte cekur 120 dit apo 4 muaj. ( keni te bashkangjitur kopjen sigurimit nga faqja e zyres se prokurimit ne Gjakove, ku dhe nga aty kemi mar informatat pasi eprokurimi shpesh here ka pasur probleme sa i perket menyres elektronike, dhe shpesh here ka qen e pamundur te hapet faqja zyrtare e eprokurimit. Ne me te njejtin nr te prokurimit kemi mar informatat ne faqen e zyres se prokurimit ne Gjakov dhe jemi bazuar ne ate dhe kemi ber sigurimin sipas kushteve te kerkuar nga kjo zyre. Ndersa ne pikerisht per kete kemi mar verejtej.
- d. Eshte pak e pa kjart te numeri i prokurimit Psh: nr i prokurimit ne dosje te tenderit eshte 63217335121. ndersa ne vedimet qe kemi pranuar nga zyra e prokurimit nr i prokurimit eshte 63217001 121.
- e. Eshte shtyer disa here dita e vlersimit nga komisioni per vlersim te tendereve...

### **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: "Furnizim me produkte ushqimore, higjenike dhe mish për nevojat e Komunës së Gjakovës Lot 1", me nr. të Prokurimit: 623/17/335/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Gjakovë.





Ne si operator ekonomik jemi te pakenaqur me vendimin final nga zyra e prokurimit ne Gjakove. Ne si operator jemi te bindur ne manipulim ose nderhyrje ne dokumenta, perndryshe eshte e quditshme se si mund anulohet nje kompani me munges dokumentacioni dhe te shpallet fitues nje tjetër kompani ne munges te dokumentacionit. E gjithë kjo bindje e dyshimit shtohet kur zyra e prokurimit thirret ne ate se kompania Burimi ka vetem nje kopje. Atehere ne si kompani si mund te kemi qasje ne dokumenta kur eshte vetem kopja e hapur dhe pikerisht ne at kopje dyshojm per nderhyrje. Per te qen edhe ma te sigurt per manipulim dhe procedura jo te regullta ne kemi mar informacione dhe posedojm deshmi edhe ne ditën e vlersimit nga komisioni vlersues qe kompania Burimi kishte prap munges dokumntacioni dmth edhe pas nderhyrjes ne dokumenta qe ne dyshojm dhe jemi te sigurt, prap ka pasur munges dokumentave (e keni te bashkangjitur kopjen nga dita e vlersimit nga komisioni vlersues te cilën e kemi siguruar ne). Prandaj kerkojm nga Organi Shqortues i Prokurimit qe te meret seriozisht ne rastin dhe te mer te gjitha procedurat e nevojshme qe te zbardhet e verteta ne nderhyrje ne dokumentave, nga zyrtar te zyres se prokurimit ne Gjakove. Sa i perket asaj se si eshte e mundur te shpallet nje fitues me cmim me te lart me munges dokumentacioni dhe te anulohet kompania me e lir ne cmim po ashtu ne munges dokumentacioni kemi kerkuar sqarim permes menyres elektronike disa here por ne ket pyetje jemi injoruar gjdo here. Pastaj kemi shkuar edhe fizikisht qe te marim pergjigje ne ket pyetje dhe prap jemi injoruar dhe jemi pritur shum keq. Dhe qka eshte me rendesi te ceket se me datën 27.03.2017 kemi ber ankesën dhe menjehere me 28.03.2017 kemi mar emailin dhe jemi njoftuar per pezullim te aktivitetit .Ndersa te nesermen me 29.03.2017 kemi mar emailin tjetër dhe jeni njoftuar se kerkesa per rishqyrtim eshte hedhur posht nga komisioni vlersues e qe eshte pak e quditshme pasi qe ka qen shume koh e shkurter dhe nuk besojm qe komisioni per rivlersim eshte mbledhur per nje koh aq te shkurter, Por besojm se vetem perfaqesuesja e zyres se prokurimit ka hedhur posht ket kerkes per rishqyrtim. (te bashkangjitura keni kopjet e shkembimeve te emailave dhe vendimeve).

#### *Dëmet material*

Se pari ju njoftojm se zyra e prokurimit ne Gjakov na ka shkaktuar shume strese dhe presion psiqik. Se dyti na ka mar shum koh per ankesa dhe informata te cilat kan shkaktuar shkelje gjat procedures. Dhe se treti kemi shpenzuar mjaft te holla mrenda gati dy muajve per shpenzime te ndryshme materiale, prej keshillimit nga zyrtar te ndryshem, Jurist e deri te procedurat ligjore te cilat mendoj qe na kan shkaktur pa nevoj.

#### **Procesi i prokurimit:**

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	09.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Furnizim/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas zgjatjes së afatit,	24.02.2017
Afati i parapare për hapje të ofertave, pas zgjatjes,	24.02.2017
Data e hapjes së ofertave	23.03.2017

#### **Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:**

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: "Furnizim me produkte ushqimore, higjenike dhe mish për nevojat e Komunës së Gjakovës Lot 1", me nr. të Prokurimit: 623/17/335/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Gjakovë.



Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Pashtriku"		Lot III - 32,226.39€	JO
2.	"Troja"	Prishtinë	Lot III - 38.540.00€	JO
3.	"Burimi"	Prishtinë	Lot I - 55.603,67 € Lot II - 25.???,22 €	Dajaku Lux, nuk ka plotesu f.c (???)
4.	"Dujaku Lux"	Gjakovë	Lot I - 47,873.?? € Lot II - 34,266.00 € Lot III- 37,355.?? €	OE – Burimi, ka vetem nje kopje
5.	"Apetiti"	Vushtrri	Lot II- 28.205.00 €	Dy firmat jan ne munges dokumentacioni, Burimi dhe Dajaku Lux

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 23.03.2017, konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë pesë 5) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur, ndersa per lot 1, ku eshte parashtruar ankese kan ofertuar dy(2) OE.

#### Komisioni vlerësues pranë AK:

##### **Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.**

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Myrvete Syka
- - Anëtar i komisionit - Nergize Haxhidaui
- - Anëtar i komisionit – Gjylsene Brovina

Data e mbarimit të vlerësimit: .....17.03.2017

Data e nënshkrimit të raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:..... 17.03.2017

#### Raporti i komisionit vlerësues:

Sipas rekomandimit të komisionit të vlerësimit nga 5 (pese) operator ekonomik, 2 (dy) ishin të përgjegjshëm, NPT "Burimi" për lotin –I- dhe lotin II- NPT "Pashtriku", dhe komisioni i vlerësimit rekomandon për kontratë.

#### Kriteret për vlerësim

<b>III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: -</b>  Operatori Ekonomik duhet ti përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04/L-42.  - Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës.	<b>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</b>  - Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.  - Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit
---	---

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: "Furnizim me produkte ushqimore, higjienike dhe mish për nevojat e Komunës së Gjakovës Lot 1", me nr. të Prokurimit: 623/17/335/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë.

<p>- Vërtetim nga Gjykata kompetente.</p> <p><b>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit</li> <li>- Certifikata e Numrit Fiskal</li> <li>- Certifikata për Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK</li> </ul> <p><b>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b></p> <p>- Pjesa e I-rë: - Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë të natyrës se njëjtte në 3 (tri) vitet e fundit. - Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek Autoriteti Kontraktues të paktën një foto për secilin produkt të ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve (në formën e një katalogu). - Pjesa e II-të: - Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë të natyrës se njëjtte në 3 (tri) vitet e fundit. - Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek Autoriteti Kontraktues të paktën një foto për secilin produkt të ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve (në formën e një katalogu). - Pjesa e III-të: - Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë të natyrës se njëjtte në 3 (tri) vitet e fundit.</p> <p><b>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</b> N/A</p>	<p>(vlen për OE fitues).</p> <p>- Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar (Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vlen për OE fitues).</p> <p><b>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).</li> <li>- Certifikata e numrit fiskal (kopje).</li> <li>- Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).</li> </ul> <p><b>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</b></p> <p>Listën me referenca në të cilën specifikohen të gjitha furnizimet e Operatorit Ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar furnizimet e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të furnizimeve; - Katalogu</p> <p><b>Dëshmia e kërkuar dokumentare: N/A</b></p>
---	--



## Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 306)

**Ekspteri shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:**

**Sqarimi nr - 1.** Autoriteti Kontraktues / Komuna Gjakovë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike (kornize – 12 muaj) me vlerë të mesme, operatori ekonomik NTP “Dujaka Lux”, ka parashtruar ankesë kundër njoftimit për dhënje të kontratës në lot 1, të këtij aktiviteti të prokurimit, gjegjësisht kundër arsyetimit të eliminimit të shprehur në letër standarde.

- Kunder njoftimit për dhënje të kontratës në lotin 1, parashtruesi i ankesës, me datën 27.03.2017, parashtron kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, me pretendimet ankimore se është rekomanduar për dhënje të kontratës operatori ekonomik i cili nuk ploteson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Kundrejt të njejtës kërkesë AK – Komuna Gjakovë, më datën. 29.03.2017, nxjerr vendim dhe hudhë posht kërkesën si të pa bazuar.

**Sqarimi nr - 2.** Fillimishtë sqarojmë se për këtë aktivitet të prokurimit, sipas përshkrimit në procesverbalin e hapjes së ofertave, kater (4) operator, kanë dorëzuar oferta fizike ndërsa një (1) ka ofertuar në formë elektronike. Poashtu tek rubrika e vërejtjeve, pjesë e raportit të hapjes së ofertave, janë përshkruar vërejte dhe atë si më poshtë:

- “Dujaku Lux, nuk ka ploresu f.C”,
- “OE Burimi ka vetëm një kopje”, dhe
- “Dy firmat janë munges dokumentacioni Burimi dhe Dujaka Lux”. Ndërsa si arsye e eliminimit në letër standarde kundrejt OE ankues NTP “Dujaku Lux”, AK- Komuna Gjakovë ka theksuar: “Pjesa C”, nuk i ploteson kërkesat në FDT..., Sigurimi i tenderit nuk i ploteson kërkesat e FDT (është kërkuar sigurimi për 120 dite, ju keni ofruar sigurim 90 ditë)”.

Lidhur me atë që u tha më lartë sqarojmë se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënje të kontratës në lot, 1, NPT “Burimi”, në përjashtim të ofertës me përshkrimin “Origjinali”, posedon edhe një të tillë me përshkrimin “Kopje”, ndërsa ofertuesit tjerë të cilët kanë ofertuar me kopje fizike posedojnë, në përjashtim të origjinalit edhe nga dy kopje.

Ndërsa sa i përket letrës standarde, arsyetimit të eliminimit të parashtruesit të ankesës, sqarojmë se formulari i tenderit, gjegjësisht “Pjesa C”, pjesë e ofertës së OE ankues, nuk përmban përshkrim të çmimit të ofertes, ndërsa sigurimi i tenderit poashtu pjesë e ofertës së parashtruesit të ankesës, vlefshmerine e ka të përshkruar në periudhën kohore prej nëntëdhjetë (90) ditë, gjegjësisht nga data 24.02.2017, deri më 25.05.2017.

Përfundimishtë lidhur me atë që u tha më lartë sqarojmë se nuk kemi hasur se AK- Komuna Gjakovë, në dosje të tenderit apo në njoftim për kontratë, ka paraparë për ofertuesit numrin e kopjeve fizike që duhet të dorëzojnë. Neni 32, paragrafi 3, i UOPP-së, shprehimisht thot: “Tenderi do të dorëzohet te AK në një formë të origjinalit dhe një numër të kopjeve të cilat AK i ka kërkuar në menyre të qarte në dosjen e tenderit ...”.

Poashtu lidhur me sigurimin e tenderit AK – Komuna Gjakove, tek pika 13.2, e FDT-së, ka kërkuar periudhën e sigurimit në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, ndërsa në pikën 22.1, të

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: “Furnizim me produkte ushqimore, higjienike dhe mish për nevojat e Komunës së Gjakovës Lot 1”, me nr. të Prokurimit: 623/17/335/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë.

FDT-së, vlefshmerin e denderit e ka kërkuar për tre (3) muaj.

Megjithatë e njehta kërkesë në njoftim për kontratë nuk është e njejtë, është kërkuar që sigurimi i tenderit të ofrohet për tre (3) muaj, ndersa periudha e vlefshmërisë të jetë dy (2) muaj. Veprimi – përshkrimi, si i tillë paraqet mos respektim të nenit 27, paragrafi 4, të LPP-së, ku thuhet: "... Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike". Parashtruesi i ankesës përmes deklaratës po në ankesë potencon se i është mohuar qasja në dokumentacionin tenderik, megjithatë sipas shkresave të lëndës që kishim në posedim nuk kemi hasur në ndonjë shkresë – kërkesë për qasje, rrjedhimisht pretendimet ankimore i kualifikojmë si të bazuara pjesërisht.

#### Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Bazuar në sqarimet e cekura në raport, i propozojmë panelit shqyrtues që loti 1, i aktivitetit të prokurimit me titull: "*Furnizim, me produkte ushqimore, higjenike dhe mish për nevojat e Komunës së Gjakovës*", me numër prokurimi: 623/17/335/121, iniciuar nga AK - Komuna Gjakovë, të ANULOHET, dhe i njehti lot të Ri-tenderohet, nëse AK, ende shpreh interes për të, ndërsa ankesa e OE NTP "Dujaka Lux", të aprovohet si e bazuar pjesërisht.